

V E N D I M
Nr.77, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.91 Akti që i përket:

KËRKUESE: DEGA E PARTISE SOCIALISTE MAT, përfaqësuar nga Kryetari i Komitetit Drejtues, Agim Hysa.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj, me autorizim.

2. HALIL LALAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar me deklaram nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

3. GANI HOXHA, kandidat për deputet i pavarur mbështetur nga koalicioni “Bashkimi për Fitore”, në mungesë.

O B J E K T I:

Shpallja e pavlefshmërisë së vendimit nr.968, të datës 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.17 Mat

BAZA LIGJORE:Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 141 i Kodit Zgjedhor

Kërkuesi ka parashtruar një seri shkaqesh për shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat pasqyrohen me hollësi në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pas përfundimit të zgjedhjeve në datën 24.6.2001 për Kuvendin e Shqipërisë, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.17 ka shpallur fitues kandidatin për deputet të koalicionit “Bashkimi për Fitore” zotin Gani Hoxha, zgjidhje kjo që është miratuar edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.968, datë 27.6.2001.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën për shfuqizimin e këtij vendimi dhe i dha fund diskutimeve në fazën e bisedimeve në Dhomën e Këshillimit, arriti në përfundimin se dega e Partisë Socialiste Mat nuk legjitimohet në ushtrimin e kësaj kërkesë.

Në bazë të shkronjës “P” të nenit 134 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të partive politike.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite del se atë mund ta investojnë për shqyrtimin e këtyre çështjeve vetëm këto parti, por jo edhe degët e tyre nëpër rrethe.

Një konkluzion i tillë gjen mbështetje edhe në formulimin e nenit 2 pika 25 të Kodit Zgjedhor,

kur si subjekte zgjedhore janë përcaktuar vetëm partitë politike ose koalicionet e tyre të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kandidatët që këto kanë paraqitur ose kandidatët e pavarur.

Meqenëse dega e Partisë Socialiste Mat nuk përfshihet në rrethin e këtyre subjekteve, kërkesa e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur kësaj nuk i janë paraqitur kërkesa nga këto subjekte, duhet rrëzuar për mungesë legjitimitimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 shkronjat “e dhe f” të Kushtetutës dhe nenit 140 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.